



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:240467
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05453255

AC-I-23-0216

Në ankesën e

Paditësi

I S, nga Fushë Kosova, i përfaqësuar nga avokati K B nga Hajvalia.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH. "Auto Prishtina", (në likuidim), Prishtinë, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj, dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-0681 të datës 23 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-0681 i datës 23 mars 2023.**

3.Lënda kthehet në rigjykim në Shkallën e I-rë të DHPGJS, tek gjyqtari përkatës.

4.Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 29 prill 2015, paditësi e dorëzon një padi në DHPGJS për pagesën e pagave të mbetura e të pa paguara nga NSH "Auto Prishtina", në Prishtinë. Me këtë padi kërkohet nga Gjykata që të detyrohet e paditura të paguaj borxhin kryesor për paga të pa paguara për periudhën tetor 2003 deri në qershor 2014, në shumë prej 74,750.00 euro, si dhe ka kërkuar kamatën ligjore në vlerë prej 3.5 % për çdo vit. Në këtë padi paditësi nuk cek ndonjë vendim të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në padi paditësi pohon se ai vazhdimisht i ka kërkuar pagat nga NSH-ja e paditur në bazë të kontratës së punës dhe atë deri në fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së për çka ai pohon se e ka pranuar një Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe mundësinë e paraqitjes së kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit. Në padi ai pohon se kishte rezistuar me punëtor të tjerë për uzurpimin e pronës së NSH-së, nga ana e ndërmarrjes private e cila e kishte marrë asetet e NSH-së, me qira, mirëpo as AKP-ja as menagjmenti i NSH-së, dhe as ndërmarrja nuk kanë siguruar funksionim normal të NSH-së, kështu që punëtorët nuk kishin mundësi të punonin pa pengesa për çka punëtorët nuk ndihen fajtor. Bashkë me këtë padi paditësi dorëzon autorizimin e avokatit, Njoftimin drejtuar Autoritetit të Likuidimit për të paraqitur padi në DHPGJS, dokumentin e regjistrimit të NSH-së në ARBK, Njoftimi drejtuar Autoritetit të Likuidimit për dorëzimin e padisë në Gjykatë, një shkresë të AKM-së drejtuar Drejtorit të kompanisë "Auto Kosova", B S, e datës 18 nëntor 2004, një shkresë tjetër e AKM-së drejtuar drejtorit të "Auto Kosova", B S e datës 19 gusht 2004, një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë marrë paga sipas kontratës së punës e dorëzuar në AKP me 12.09.2014, kontratën e punës të datës 13.10.2003, një deklaratë drejtuar zyrës rajonale të Prishtinës, fotokopjen e Librezës së punës e hapur në vitin 2000 dhe e pa mbyllur.

Me datë 30 mars 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS e lëshoi një urdhër për paditësin me të cilën ka kërkuar që në afat prej 7 ditësh të dorëzoi vendimin e ankimuar të

Autoritetit të Likuidimit si dhe provat tjera të cilat deri me tani nuk janë dorëzuar për ta mbështetur kërkesën për paga.

Me datë 13 prill 2022, paditësi e dorëzoi një parashtrësë në DHPGJS si përgjigje ndaj urdhrit. Më këtë parashtrësë , ai ,ka dorëzuar 3 Vendimi të Autoritetit të Likuidimit PRN126-0167 i datës 29 prill 2015, i cili i referohet kërkesës për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, Vendimin PRN126-0166 të datës 12 qershor 2015 i cili i referohet pagave të pa paguara për periudhë të pa caktuar dhe shumë të pacaktuar si dhe Vendimit PRN126-0165 i datës 31 mars 2015,i cili i referohet kërkesës për paga të pa paguara për periudhën tetor 2003 e deri në qershor 2014 në shumë prej 74,750.00 euro, si dhe ka dorëzuar provat që edhe më herët i kishte dorëzuar me ankesë.

Me datë 21 prill 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në padi. Në mbrojtjen në padi AKP-ja ka pohuar se padia nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë nga neni 70.2 i Shtojcës së LDHP. AKP-ja pohon se paditësja ka dështuar të tregoj se cili nen është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditëses është parashkruar pasi që ajo nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi ti ketë kërkuar këto paga brenda 3 viteve e më së voni nga shtatori i vitit 2003, kur pretendohet se nuk janë paguar pagat nga NSH-ja. Me këtë parashtrësë AKP-ja ka dorëzuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN126-0109 të datës 31.03.2015.

Me datë 12 maj 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshoi edhe një urdhër për paditësin, me të cilën është kërkuar që ai të saktësoj se ndaj cilit vendim është paraqitur padia, ti paraqet shkaqet e padis, bazën juridike të kërkesës, provat që vërtetojnë lartësinë e pagës së kërkuar nga paditësi, të dorëzoj njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, formularët e kërkesës kreditore si dhe prova për mënyrën e llogaritjes së shumës së kërkuar si ekspertiza për secilin muaj dhe vit.

Me datë 25 maj 2022, AKP-ja e dorëzoi kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsëritë pretendimet e veta të cekura në mbrojtjen në ankesë. AKP-ja pohon se përveç që kërkesa është parashkuar, NSH-ja nuk ka kryer aktivitet ekonomik dhe në periudhën kontestuese paditësi nuk ka punuar për NSH-në, ndërsa kontrata e ofruar e punës, është mes paditësit dhe ndërmarrjes private e jo ndërmarrjes shoqërore.

Me datë 28 shkurt 2023, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS me të cilën ai e ka informuar gjykatën se avokati i tij ka ndërruar jetë, andaj autorizimi bartët tek avokati K B nga fshati Hajvali.

Me datë 23 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-0681, e aprovon kërkesë padinë e paditësit si të bazuar, e obligon të paditurën ti paguaj paditësit shumën në emër ndryshimit të pagave të pa paguara prej 74,740.00 euro për periudhën tetor 2003 deri qershor 2014 ,dhe vendos që kjo pagesë të kryhet sipas nenit 40 par 1 nën paragrafi 1.6.7 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se në periudhën në të cilën paditësi i pretendon pagat, NSH-ja nuk ia ka paguar ndryshimin e pagave, ndërsa paditësi në vazhdimësi i kishte kërkuar pagat e pa paguara sipas kontratës së punës, ndërsa e paditura e ka konfirmuar ekzistimin e këtij detyrimi. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësi ka sjell Librezën e punës nga e cila shihet se ajo është hapur në vitin 2000, por nuk është mbyllur asnjëherë për kundër faktit të privatizimit të NSH-së. Tutje shkalla e I-rë konstaton se me listën e punëtoreve me të cilën vërtetohet se nuk janë marrë pagat, është vërtetuar se paditësi ka qenë në listë në numrin 1. Në listën e pagave, paga mujore pasqyrohet për secilin punëtor e në rastin konkret paditësi e kishte pagën në shume prej 660.00 euro. Akontacioni mujor i pranuar nga paditësi ishte 85 euro, ndërsa diferenca mujore ishte 575 euro. Paditësit duhet ti njihet e drejta në diferencën e pagave për periudhën kohore për 130 muaj (tetor 2003-qershor 2014), në shumë të përgjithshme prej 74,740.00 euro. Për këto prova AKP-ja nuk është deklaruar edhe pse i ka pasur. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se në rastin konkret, paditësi ishte punëtor të NSH- deri me 21.07.2014, kur edhe filloj procedura e likuidimit ndaj NSH-së. Andaj bazuar në këto prova dhe në nenin 387 të LMD-së, paditësit i është njohur borxhi për diferencën e pagave të pa paguara deri në dhjetor të vitit 2012, pasi që paditësit i është ndërprerë parashkrimi duke

qenë se NSH-ja për cdo muaj ka paguar një pjese të pagës mujore prej 85 euro nga paga e tërësishme e tij, e që sipas kontratës së punës ishte 660.00 euro. Shkalla e I-rë konsideron se kërkesa për pagesën e diferencës së pagave të pa paguara, nuk është parashkruar në bazë nenit 387 të LMD-së

Me datë 12 prill 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përmes postës një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-0681 të datës 23 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar, ose lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike, ndërsa është i gabuar konstatimi i Gjykatës së Shkallës së I-rë lidhur me vlerësimin që është dhënë nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesën e paditësit. Tutje AKP-ja konsideron se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që paditësi ka dështuar të ofroj prova në Gjykatë se këto paga i ka kërkuar brenda 3 viteve pranë ndonjë Gjykate kompetente. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata ka ngatërruar çështje të rëndësishme faktike dhe rrjedhimisht edhe juridike dhe për pasoj ka bërë vlerësim të gabuar dhe ka marrë Aktgjykim të pa drejtë. AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën si të pa pranueshme sepse paditësi nuk ka arritur të provoj me fakte meritën e kërkesës së tij. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë i ka ngatërruar dy çështje që janë krejtësisht të ndryshme, afatin për dorëzimin e kërkesave në bazë të dëshmisë së interesit në procedurën e likuidimit që është afat për parashtrimin e kërkesave dhe afatin e dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë e që i referohet pagave të pa paguara (afati i parashkrimit) që është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuara. Të dy afatet janë të ndara dhe të dallueshme dhe secili kreditor i NSH-së duhet ti përmbush këto dy afate në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa.

Me datë 19 prill 2023, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe kërkon nxjerrjen e Aktgjykimit plotësues lidhur me Aktgjykimin C-IV-15-0681 të datës 23 mars 2023. Në këtë parashtresë paditësi ka kërkuar që në bazë nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të vendoset edhe për kumatën ligjore si kërkesë

aksesore e kërkesë padisë, pasi që me Aktgjykimin e Shkallës së I-rë nuk është vendosur lidhur me kamatën ligjore. Kjo parashtresë përfshihet nga zyra e regjistrimit në lëndën e Kolegjit të Apelit tashmë të regjistruar, AC-I-23-0216.

Me 08 qershor 2023, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi kundërshton të gjitha pretendimet e AKP-së si të pa bazuara në Ligj, duke pohuar se ai ishte punëtor i NSH-së deri në ditën e likuidimit të NSH-së. Tutje paditësi pohon se vendimi i ankimuar i Autoritet të Likuidimit është i pa bazuar në Ligj, duke dhënë konstatimin e paqëndrueshëm se gjoja nuk isha punëtor aktiv i NSH-së. Tutje ai pohon se ky konstatimin kundërshtohet me provat që janë në dosjen e lëndës, kontratën e punës me kohe të pa caktuar , listën e punëtorëve , Librezën e punës. Tendencë për shtrembërimin e provave dhe gjendjes se vërtetuar faktike, nuk është në favor as të paditurës, pasi që AKP-ja duhet të paguaj edhe kamatën përveç pagave , e që kjo shkakton prolongon ende këtë çështje juridike, me faj i të paditurës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesave dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim. Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 29 prill 2015, përmes postës e ka dërguar një padi në DHPGJS dhe kërkon paga të pa paguara nga NSH "Auto Prishtina" (në likuidim) Prishtinë, për periudhën nga muaji tetor 2003 e deri qershor 2014, në shumë prej 74,740.00 euro.

Me këtë padi nuk është cekur asnjë vendim i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit as dhe as me padi nuk është dorëzuar ndonjë vendim i Autoritetit të Likuidimit.

Çështja e pranueshmërisë së kësaj padie, të cilën edhe AKP-ja e potencon në mbrojtje në ankesë, është adresuar nga ana e Shkallës së I-rë, me urdhrin e lëshuar me datën 30 mars 2022, por që paditësi me parashtresën e dorëzuar me 13 prill 2022, si përgjigje ndaj Urdhrit i ka dorëzuar tri vendime të Autoritetit të Likuidimit, PRN126-0167 i datës 29 prill 2015, i cili i referohet kërkesës për dëm shpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, Vendimin PRN126-0166 të datës 12 qershor 2015, i cili i referohet pagave të pa paguara në periudhë të paspecifikuar dhe shumë të paspecifikuar si dhe Vendimin PRN126-0165 i datës 31 mars 2015, i cili i referohet pagave të pa paguara për periudhën tetor 2003 e deri qershor 2014 në shumë prej 74,740.00 euro.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon edhe një urdhër për paditësin dhe kërkon nga ai që ta specifikoj se cilin Vendim është duke e ankimuar si dhe të specifikoj bazën ligjore të kërkesës dhe dorëzoi prova të reja në mbështetje të kërkesës. Në dosje nuk ka dëshmi nëse është pranuar ky urdhër, mirëpo avokati i ri i paditësit K B me datë 28 shkurt 2023 e dorëzon një parashtresë me të cilën e njofton gjykatën se avokati paraprak Sh S ka ndërruar jetë. Në këtë parashtresë ai pohon se komunikimi i gjykatës duhet të bëhet përmes tij.

Duke marrë për bazë faktin se kërkesa është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 11 shtator 2014, atëherë del që pagat nga muaji shtator 2011 e deri në muajin qershor 2014, nuk janë parashkruar, pasi që ende nuk ka kaluar afati 3 vite i parashkrimit, ndërsa pagat e tjera të periudhës së cekur janë parashkruar. Shkalla e I-rë mendon se me pagesën e akontacionit prej 85 euro nga ana e të paditurës, në bazë të nenit 387 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi i kërkesës, dhe kërkesa për pagesën e pagave nga tetor 2003-qershor 2014, nuk mund të konsiderohet e parashkruar.

Kolegji i Apelit konstaton se në këtë rast nuk është ndërprerë parashkrimi i kërkesës, edhe pse NSH-ja siç pohon paditësi, punëtorëve u ka paguar nga 85 euro, në emër të akontacionit të pagës. Paditësi ka pas interes që për pjesën e papaguar të pagës mujore prej 575.00 euro, të mos lejoj të rrjedhë parashkrimi i kërkesës, i

cili ka filluar të rrjedhë prej ditës kur ka lindë detyrimi mujor i NSH-së, që në baza mujore në periudhën e cekur të paguaj pagën e tërësishme të tij, në bazë të Kontratës së punës.

Paditësi është e qartë se kërkesën për paga e ka parashtruar vetëm me datë 11 shtator 2014, tek Autoriteti i Likuidimit, e jo edhe më herët në gjykatën kompetente.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij në Shkallën e I-rë dhe me parashtrësat e më vonshme të tij ka pohuar që vazhdimisht i ka kërkuar pagat prej NSH-së në periudhën e cekur, mirëpo ato nuk janë paguar. Nëse kjo ka ndodhë, paditësi e ka pas mundësin që të paraqesë padi në gjykatë, e të mos lejoj rrjedhjen e parashkrimit të kërkesës. Nuk ka prova se paditësi e ka kërkuar diferencën e pagave në afatin prej tri viteve në gjykatën kompetente, andaj për një pjesë të periudhës kërkesa është parashkruar.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se asetet e NSH-së "Auto Prishtina" në vitin 2000, nga autoritetet e UNMIK-ut ishin dhënë me qira një kompanie private. Paditësi nuk është e qartë nëse ka punuar në këtë kompani private që i kishte marrë asetet e NSH-së me qira.

Kolegji i Apelit vëren se Lista e pagave e hartuar dhe e nënshkruar nga Drejtori i kontestuar i NSH-së, në kohën kur ka filluar procedura e likuidimit në vitin 2014 nuk mund të konsiderohet si pranim i pagave për periudhën që kishte kaluar. Në këtë rast kjo provë është paraqitur nga vet paditësi, duke e paraqitur veten si drejtor dhe një provë e tillë në këtë fazë të procedurës ende nuk e ka kredibilitetin e provës së vlefshme në procedurë.

Është edhe një çështje, që në fakt asetet e NSH-së janë marrë me qira nga, SH. A "Auto Prishtina", por nuk ka të dhëna deri në cilin vite kjo kompani i ka pas në shfrytëzim këto asete, dhe duhet të vendoset nëse NSH-ja ka përgjegjësi kontraktuale për pagesën e pagave të punëtorëve, për periudhën kur SH. A "Auto

Prishtina”, i kishte në shfrytëzim këto asete të kësaj NSH-je, e cila gjë ka mbetur e pa adresuar.

Rrjedhimisht duke marrë për bazë faktin që pagat e kërkuara nga muaji tetor 2011 e deri në qershor 2014, ende nuk janë parashkruar, Kolegji i Apelit konstaton se në këtë çështje juridike nuk është vendosur drejtë, pasi që ende saktësisht nuk është vërtetuar as gjendja faktike.

Kolegji Apelit vëren se paditësi me datë 19 prill 2023 e ka dorëzuar një parashtresë në DHPGJS e cila nga zyra e regjistrimit është përfshirë në dosjen e Kolegjit të Apelit AC-I-23-0216, në të cilën parashtresë ai ka kërkuar që në bazë të nenit 37 par.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të vendoset edhe për kamatën ligjore.

Kolegji Apelit vëren se Shkalla e I-rë në diapozitivin e Aktgjykimit të ankimuar nuk e ka adresuar çështjen e interesit ligjor, andaj kjo kërkesë e re e paditësit përcillet tek Shkalla e I-rë, e cila duhet të trajtohet në procedurën e rigjykimit të padisë.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së aprovohet si e bazuar, anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda kthehet në rigjykim tek gjyqtari përkatës.

Prandaj nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 06 qershor 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit me 14 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
